



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:031594

Datë: 30.03.2022

Numri i dokumentit: 02856587

PKR.nr.41/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor, Haris Ramovic, në çështjen penale, kundër të akuzuarit A. D. nga K. Pejë, për shkak të veprës penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I. 24/2020 të datës 25.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 24.03.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit, Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit A. D. te njëjtën ditë pas përfundimit të seancës fillestare me dt. 24.03.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.30.03.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. D. i biri i R. dhe nënës F. e gjinisë B. i lindur me dt..... në P, me banim në K-P, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, është magjistër i burimeve njerëzore dhe menaxhim të situatave, me profesion ushtarak, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, nr..... posedon telefon mobil .../..... shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Më parë dhe gjerë me datë 23.01.2022, rreth orës 21:30, në rr. “ ” nr. në P, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një armë e llojit “z”, , me nr. serik dhe karikator i po të njëjtës armë si dhe një armë tjetër e llojit “z”, me nr. serik, me një fishek në tyt dhe dy në karikator, në atë mënyrë që, natën kritike pas marrjes së informatës se në emergjencën e spitalit është lajmëruar një person i cili kishte plagosur vetën në gisht të dorës së djathtë, të njëjtit me të dal në vendngjarje dhe pas kontrollit në shtëpinë e të pandehurit, ka rezultuar se i njëjti ka pas në posedim armët e lartcekura, e të cilat më pas janë sekuestruar,

- me çka ka kryer veprën penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21 par. 1, 38, 39 par.1 nënpar.1.3,40 par.1 nënpar.1.3,43 par.1, 69 par.1 dhe 3 nën par 3.6 dhe 3.7, 70, 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 366, 453 par.4 të KPPRK-së, të pandehurit A. D. i shqipton:

G J Y K O N

- I.** Me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri ka për ta paguar në afat prej 90 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
- II.** Nëse i pandehuri dënimin me gjobë, nuk e ekzekuton, refuzon apo dështon ta paguaj në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III.** I pandehuri A. D. lirohet nga pagesat e shpenzimeve procedurale .

Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së, ndaj të pandehurit A. D. i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET, një (1) armë e llojit “Z”, , me numër serik:,si dhe një (1) karikator të kësaj armë, dhe një (1) armë tjetër e llojit “Z”, , me numër serik:,me një fishek në tyt dhe 2 (dy) në karikator.

URDHËROHET, që një (1) armë e llojit “Z”, me numër serik:,si dhe një (1) karikator të kësaj armë, dhe një (1) armë tjetër e llojit “Z”, , me numër serik:,me një fishek në tyt dhe 2 (dy) në karikator , pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 24/2022 të datës 25.02.2022, kundër të akuzuarit A. D. nga Peja, për shkak të veprës penale, “*Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366 par.1, të KPPK-së.

Gjykata, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 24.03.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm, Prokurorja e Shtetit dhe i pandehuri A. D.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit PP/I Nr.24/2022, të datës 25.02.2022, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësin që të deklarohet

për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, konform nenit 248 par. 1, pika 1.1-1.4 të KPPRK-së.

I akuzuari pas njoftimit me të drejtat e tij, është deklaruar fajtor për veprën penale, “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, të KPPK-së. i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, e bindur se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitës së nenit 248 par 1 pika 1.1-1.4 të KPPRK-së, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes dhe shkresave të lëndës siç janë: *Raporti i policit A. Sh. i datës 23.01.2022, raporti i oficerit F. A. i datës 23.01.2022, raporti informues i përpiluar nga hetuesi A. S. i datës 23.01.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 23.01.2022, deklarata e të pandehurit A. D. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 23.01.2022, lista e dëshmimeve e përpiluar nga Njësia e Forenzikës e datës 23.01.2022, fotografitë e armëve e pjesëve tjera përcjellëse si dhe shkresat tjera të lëndës ,dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar dhe nuk është gjetur se aktakuza përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike.*

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit Arianit Dedushaj, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, të KPPK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe keqardhjen për veprën e kryer , duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij. Po ashtu sipas shkresave të lëndës nuk figuron se i njëjti ka qenë i gjykuar nga gjykata në të kaluarën për ndonjë vepër penale. Si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata në kuptim të nenit 73 të KPRK-se të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPPRK-se.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobe u morr konform nenit 40 par. 1, pika 1.3, nenit 43 dhe nenit 366 par. 1, të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit te dënimit nga gjoba në dënim burgimi do merret në aplikim te nenit 43 par.3, të KPRK-ës, në rast kur i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaj në shumen e gjobës prej 600 (gjashtëqind) euro si në piken I, te dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 453 par. 4 te KPPK-se, gjykata e liroi te pandehurin nga paguarja e shpenzimeve procedurale ,si dhe taksave tjera për kompensimin e viktimave, pasi qe i njëjti është veteran i luftës bazu ne kartonin qe ndodhet ne shkresa te lëndës.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
DKR.nr.41/22 dt. 30.03.2022

Praktikanti gjyqësor
Haris Ramovic

Kryetari i trupit gjykues,
Dr. sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.